



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Konferenca Ndërkombëtare
"Globalizimi dhe integrimi në edukimin bashkëkohor"

24-25 Qershor 2021

Thirrja e parë

Fakultetit i Shkencave të Edukimit, në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" shpall thirrjen e parë për pjesëmarrje dhe bashkëpunim në Konferencën Ndërkombëtare "Globalizimi dhe integrimi në edukimin bashkëkohor", e cila do të mbahet më 24-25 Qershor 2021. Konferenca synon të bëjë së bashku studiues nga fusha e edukimit, akademikë, drejtues dhe mësues të sistemit të arsimit parauniversitarë, specialistë psiko-socialë dhe studentë për të diskutuar dhe trajtuar sfidat, me të cilat po përballemi aktualisht, si dhe perspektivat në fushën e edukimit bashkëkohor.

Tematikat kryesore të kësaj konference do të fokusohen dhe do të trajtojnë studime dhe referime nga fushat e mëposhtme:

- Sfidat e Arsimit të Lartë
- Shërbimi psiko-social në shkolla
- Arsimi parauniversitar, sfidat dhe risitë e pandemisë
- Perspektivat e mësimdhënies bazuar në teknologji

Data të rëndësishme:

Dërgimi i abstraktit	5 Maj
Njoftimi i pranimit të abstraktit	20 Maj
Data e konferencës	24-25 Qershor 2021
Vendi	Universiteti i Elbasanit "A. Xhuvani" Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Elbasan
Gjuha zyrtare e konferencës	shqip, anglisht
Adresa zyrtare	konferencashe2021@uniel.edu.al

Informacione të rëndësishme .

Tarifa e pjesëmarrjes është 3 mijë lekë për një autor; për çdo bashkautor shtohet 1 mijë lekë

Detaje teknike

- Shkrimi në formatin A4, lloji i gërmës:12 pt., font - Times New Roman.
- Punimi duhet të jetë origjinal dhe i pa publikuar më parë.
- Punimi duhet të dorëzohet në rrugë elektronike në adresën mëposhtme, e-mail: konferencafshe2021@uniel.edu.al
- Konfirmimi për pranimin e abstraktit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të aplikantit.

Kërkesat kryesore mbi abstraktin:

Titulli i studimit: 12 points Times New Roman, bold, centered.

- **Emri i autorit:** Emri i plotë i autorit (autorëve), statusi, institucioni dhe adresa e-mail për secilin prej autorëve (12 points Times New Roman).
- **Përmbajtja:** Abstrakti duhet të jetë 150-250 fjalë dhe të paraqesë objektivat dhe metodologjinë e kërkimit, rezultatet dhe rekomandimet (12 points, Times New Roman, Justified, Single-space).
- **Fjalë kyç:** 3-6 fjalë (12 points, Times New Roman, italic)
- **Formati:** Abstrakti duhet të dorëzohet në format Microsoft Word (97-2003 document)

Ju mirëpresim në Elbasan, 24-25 Qershor 2021!